



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS – “Projekte teknike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
22114311-5 Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT – 3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 , autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruar me Aktin e Ekspertizës së Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur ato janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të auditorit ligjor dhe kontabël të miratuar”, i ndryshuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse dy bilance të njepasnjeshme të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% të vlerës së për llogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës ose fature tatimore të shitjes, ku shënohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për projekttime**. Licencë profesionale të shoqërisë për projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore përkatëse sipas *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*. të vlefshme, për kategoritë si më poshtë:

Licensat e kerkuara

- **1/a:** Studime pjesore Urbanistike;
- **2/a:** Projektim arkitektonik për objekte civile-industriale-vepra arti në infrastrukture;
- **2/d:** Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe;

- **3/a:** Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet betonarme deri ne 5 kate;
- **4/a:** Instalime hidrosanitare;
- **4/b:** Instalime termoteknik – ventilimi – kondicionimi;
- **4/c:** Linja e rrjete elektrike – telefonike – radiotelefoni – citofoni – sistem alarmi – televizive etj, për objekte civile, industriale, turistike;
- **5/b:** Furnizim me ujë – kolektor shkarkimi;
- **6/a:** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore
- **8/a:** Bazamente gjeodezike, rlevime në të gjitha shkallët;
- **9/a:** Studim/Vlerësim gjeologo- inxhinierik i trojeve të buta
- **11/a:** Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 germa a të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Licensa 1/a kerkohet pasi procedura kerkon studimin e PDV-se per siperfaqen e planifikuar ku do te realizohen ndertime pas hartimit te projektit te zbatimit.

2/a eshte kerkuar pasi kjo license perfshine profesionet arkitekt, urbanist dhe planifikues territori. 2/d meqenese ne projekt ide jane planifikuar krahas ndertimeve edhe punime te peisazhit, sistemimeve te hapsirave midis ndertimeve, planifikime per lulishte, kende lojrash dhe parqe per femije.

3/a kjo license eshte kerkuar pasi te gjithë objektet jane ndertime civile me sisteme beton armeje, kolone, tra deri maksimumi 5 kate.

4/a pothuajse te gjithë objektet qe do te ndertohen pavaresisht nga funksioni i tyre kane nevojë per instalime hidro-sanitare.

4/b meqenese klima eshte pergjithesisht e ashper dhe kerkohen instalime te rrjeteve qe kane te bejne me funksionimin e sistemit te kondicionimit dhe ventilimit eshte e nevojshme licenca e mesiperme.

4/c ne te gjithë objektet do te instalohet rrjeti elektrik, sistemet e alarmit, sistemet e mbrojtjes nga zjarri dhe rrjeti i citofonise.

5/b ne projekt per te gjithë objektet duhet te planifikohen rrjetet e furnizimit me uje te pishem dhe shkarkimin e atyre te perdorur.

6/a per te aksesuar qytetaret ne perdorimin e ketyre objekteve do te planifikohen nje rrjet rrugor auto-urban i brendshem dhe i integruar ne rrjetin interurban.

8/a meqenese siperfaqia ku do te realizohet ndertimet pergjithesisht eshte e pa zhvilluar eshte e domosdoshme realizimi i studimeve topogjeodezike dhe rlevimeve ne te gjitha shkallet.

9/a meqenese per truallin ku do te realizohen punimet nuk kemi studime te mirefillta te truallit per sa i perket perberjes dhe shtresezimit eshte e nevojshme qe OE i interesuar per kryerjen e ketij sherbimi te jete i pajisur dhe me kete license.

11/a meqenese kemi te bejme me punime ne zone urbane eshte e domosdoshme qe sistemi i rrugeve te brendshme dhe atyre qe lidhet me rrjetin ekzistues te jet e te paisur me sinjalistiken e domosdoshme horizontale dhe vertikale.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin projektues, sipas listes se meposhtme ose/edhe ne bashkepunim me operatoret e tjere:

Stafi për shërbimin e projektimit , duhet të jenë minimalisht:

- Ing.Ndërtimi, 1(nje)
- Arkitekt, 1(një);
- Ing.Gjeolog, 1(një);
- Ing.Mekanik, 1 (një);
- Ing.Hidroteknik,1 (nje);
- Ing.Elektrik, 1(një);
- Ing. Gjeodet, 1(një).
- Urbanist 1(nje)

Drejtuesi Teknik i shoqerise duhet te jete nje nga profesionet e mesiperme dhe me eksperience pune 5 vite e lart.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme,, Diplomë. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledëes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

1. Inxhinier Ndertimi është profesioni që ka lidhje direkt me përcaktimin e konstruksioneve të sistemeve, muraturave, shtresave, armimeve të hekurit për të gjithë objektet që do të ndertohen pavarësisht llojit të tyre.
2. Arkitekt ka të bëjë me përcaktimin dhe arëduarimin e ambienteve brenda objekteve.
3. Inxhinier Gjeolog ka të bëjë me përcaktimin dhe qëndrueshmërinë e truallit ku do të ndertohen objektet, në relacionin e tij përcaktohet përberja formacioneve poshtë kuotes zero nga ku fillon ndertimi i objektit.
4. Inxhinier Mekanik përgjigjet për sistemet termodinamike brenda objekteve që kanë të bëjnë me funksionimin e linjave nën presion për sisteme të ndryshme sipas rastit.
5. Inxhinier Hidroteknik përgjigjet për sistemet e funksionimit të rrjeteve hidraulike.
6. Inxhinier Elektrik në të gjithë objektet do të vendosetn sistemet e ndriqimit dhe rrjete të ndryshme të lidhura me të.
7. Inxhinier Gjeodet ka të bëjë me studimet dhe rievimet e të gjithë llojeve.
8. Urbanist, në territorin ku do të realizohen punimet do të kryehen studime urbanistike që kanë të bëjnë me hartimin e PDV-se.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledëes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.